



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Nr. 3842  
Prot.

Tiranë, më 28/02/2022

UDHËZIM

Nr. 8 Datë 28/02/2022

“PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM VENDOR 2023-2025”

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë:

UDHËZON:

**I. Afatet e përgatitjes të kërkesave të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025**

1. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave jo më vonë se data 1 mars 2022. Raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave përmban të dhënat për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme buxhetore.
2. Në këtë raport përfshihet:
  - a) metodologjia e përdorur për parashikimin e të ardhurave;
  - b) analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose ndryshimit të atyre ekzistuese; dhe
  - c) analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre.
3. Kryetari i NJVQV-së përgatit dhe propozon për miratim në Këshillin e NJVQV-së Tavanet Përgatitore të PBA 2023-2025.
4. Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025 për çdo program, miratohen nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 15 mars.
5. Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA 2023-2025 për çdo program, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton Udhëzimin e Brendshëm të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe e shpërndan tek secili Drejtues i Ekipit të Menaxhimit të Programit (DEMP).

6. Udhëzimi i Brendshëm i Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore përmban:
  - a. Listën e programeve buxhetore dhe përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve;
  - b. Tavanet Përgatitore të PBA 2023-2025 për çdo program, për tre vitet e ardhshme buxhetore.
  - c. Afate të detajuara për Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për përgatitjen e kërkesave të shpenzimeve sipas programeve të PBA-së 2023-2025.
7. Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP), paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Kordinatorit të GMS, brenda muajit prill 2022. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet.
8. Kërkesat buxhetore të dorëzuara te kordinatori i GMS vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore.
9. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 1 Qershor 2022 duhet të dërgojë me shkrim dhe në rrugë elektronike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Projekt-dokumentin e PBA 2023-2025, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
10. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, analizon dhe përgatit një raport me rekomandime mbi Projekt-dokumentin e PBA 2023-2025 për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe ja dërgon zyrtarisht këtyre të fundit brenda datës 20 qershor.
11. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore organizon takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së.
12. Këshilli i NJVQV-së mund të zhvillojë konsultime me publikun në fazën e parë dhe strategjike të përgatitjes së PBA-së si dhe në fazën e dytë, sipas kalendarit të përgatitjes së PBA-së.
13. Kryetari i NJVQV-së paraqet pranë këshillit të NJVQV-së, Projekt-dokumentin e PBA 2023-2025, të miratuar nga Grupi për Menaxhim Strategjik, së bashku me raportin me rekomandime të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
14. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore shqyrton dhe miraton Projekt-dokumentin e parë të PBA 2023-2025, dhe shpreh opinionin e tij mbi rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë brenda datës 30 qershor 2022.
15. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 korrik 2022, merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025.
16. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2023-2025 dhe për përcaktimin e nivelit të pagave duhet të bazohen në kuadrin ligjor të miratuar gjatë vitit 2022.

## **II. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore**

17. Niveli i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2023-2025, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore deri në vitin

2022. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.
18. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2023-2025, paraqitet në shtojcën 1 “Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2023-2025”, bashkëlidhur udhëzimit.
  19. Niveli i transfertës së pakushtëzuar sektoriale, për funksionet e transferuara në nivel vendor në vitin 2016, për periudhën 2023-2025, bazohet në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të miratuar (shtojca nr.3).
  20. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2023-2025 do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar me buxhetin e vitit 2022.

### **III. Proceset për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025**

#### **3.1 Dokumente që duhen marrë në shqyrtim gjatë përgatitjes së PBA 2023-2025**

- a) Udhëzimet e MFE dhe Udhëzimi i Brendshëm i NJVQV-së për përgatitjen e PBA Vendor 2023-2025;
- b) Plani Strategjik i Zhvillimit/Plani i Përgjithshëm Vendor (i teritorrit, plani social, plani i zhvillimit ekonomik, plani për mbrojtjen e mjedisit), të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore;
- c) Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal;
- d) etj.

#### **3.2 Proceset për përgatitjen e PBA Vendor 2023-2025**

21. **Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2023-2025**, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 19 datë 13.01.2022, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025. Nëpërmjet vlerësimeve të paraqitura në Kuadrin Makroekonomik Fiskal, njësia e vetëqeverisjes vendore do të analizojë burimet që do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
22. **Tavanet e Përgatitjes së PBA Vendor 2023-2025**. Një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i planifikimit të shpenzimeve të programit të jetë në përputhje me parashikimin e të ardhurave, stabilitetin fiskal si dhe prioritetet strategjike të NJVQV-së, është vendosja e taveve të shpenzimeve. Një “tavan” në këtë kontekst është kufiri i sipërm i shumës totale të parave që mund të shpenzohen ose të planifikohen për t’u shpenzuar për një qëllim të caktuar.  
Me alokimin e Taveve të Përgatitjes së PBA Vendor 2023-2025 për programet buxhetore, Këshilli i NJVQV-së garanton që shpenzimet të planifikohen në mënyrë që të buxhetojnë politikat, prioritetet, objektivat strategjike të njvqv-së dhe të jenë në përputhje me alokimin strategjik të burimeve.
23. **Organizimi Institucional**. Manaxhimi i brendshëm i Procesit të përgatitjes së PBA-së brenda NJVQV-së bazohet në mbledhjet e Grupit për Menaxhim Strategjik dhe mbledhjet e secilit prej Ekipeve të Manaxhimit të Programeve (EMP). Secila nga këto mbledhje është e lidhur me një fazë të rëndësishme të përgatitjes së PBA-së brenda NJVQV.

Mbledhjet e GMS dhe mbledhjet e EMP janë të nevojshme për një proces të suksesshëm të përgatitjes së PBA-së. Procedura më të detajuara paraqiten në shtojcën nr.4.

24. **Gjenerimi i Pemës së Programit** është procesi llogjik për lidhjen e planeve politike (Procesi i Rishikimit të Politikës së Programit) me planet e shpenzimeve (Procesin e Planifikimit të Shpenzimeve të Programit).
25. **Përgatitja e dokumentit të PBA-së.** Bazuar në informacionet e marra nga secili prej DEMP në formën e Deklaratës së Politikës së Programit, si edhe kërkesave të shpenzimeve sipas formateve përkatëse, Koordinator i GMS me ndihmën e Sekretarit të GMS bën përmbledhjen dhe harmozimin e tyre në Projekt-dokumentin e PBA Vendor 2023-2025. Ky dokument i paraqitet për miratim GMS dhe pastaj dërgohet në MFE brenda datës 1 Qershor 2022.

### **3.3 Formatet e kërkuara për raportim**

26. Pjesë e dokumentacionit të Projekt-dokumentit të PBA 2023-2025 që duhet dërguar në MFE si edhe në Këshillin Bashkiak janë vetëm formatet output, të cilat gjenerohen nga Instrumenti i Planifikimit Financiar. Këto formate duhen dërguar të printuara/nënshkruara nga Kryetari i NJVQV-së dhe DEMP (sipas rastit).
27. Njëkohësisht, një kopje elektronike e të gjithë Instrumentit të Planifikimit Financiar duhet dërguar me email në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në adresat elektronike të paraqitura në seksionin VI të këtij udhëzimi.

## **IV. Mënyrat e llogaritjes së transfertës të pakushtëzuar dhe të kushtëzuar për njësitë e**

### **4.1 Transferta e pakushtëzuar**

#### **4.1.1 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme**

28. Madhësia e transfertës së pakushtëzuar është 1.01% e PBB-së së viteve 2023-2025 (shtojca 1).
29. Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2023-2025 do të jenë sipas përcaktimeve në nenin 24, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në përlllogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2021, kriteret e përdorurara dhe ato që do të përdoren për PBA-në 2023-2025 janë: popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit), dendësia e popullsisë për km<sup>2</sup>, numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.
30. Madhësia e koeficientëve dhe të dhënat e nevojshme për llogaritjen e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2023-2025 do të jenë në përputhje me përcaktimet e Ankesit 1, të ligjit vjetor të buxhetit 2022.

#### **4.1.2 Transferta e pakushtëzuar sektoriale**

31. Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016.

Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.

32. Bashkitë në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025 duhet të parashikojnë fonde për ofrimin e infrastrukturës së përshtatshme për ushtrimin e funksionit të arsimit parashkollor.

#### **4.2 Transferta e kushtëzuar**

33. Transferta e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025 për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara, ose të përbashkëta. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

#### **V. Instrumenti i Planifikimit Financiar**

34. Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025 do të përgatitet nëpërmjet Instrumentit të Planifikimit Financiar.
35. Pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në drejtorinë përgjegjëse për financat vendore do të ofrohet shërbimi i asistencës në ndihmë të të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore në plotësimin dhe përdorimin e Instrumentit të Planifikimit Financiar.
36. Nëpërmjet Instrumentit të Planifikimit Financiar njësitë e vetëqeverisjes vendore do të organizojnë planifikimin e shpenzimeve buxhetore në përputhje me 20 programet e përcaktuara, sipas shtojcës nr.1 të udhëzimit standard nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar. Shtojca 6, bashkëlidhur udhëzimit përcakton riklasifikimin e programeve buxhetore.
37. Çdo format i instrumentit shërben për paraqitjen e informacionit në mënyrë të përmbledhur dhe të strukturuar sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

#### **VI. Ndjekja e Procesit dhe Mbështetja Këshillimore**

38. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, vë në dispozicion për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, adresat e e-mailit: [Fran.Brahimi@financa.gov.al](mailto:Fran.Brahimi@financa.gov.al), [Elidona.Durmishi@financa.gov.al](mailto:Elidona.Durmishi@financa.gov.al), [Ardita.Xhyheri@financa.gov.al](mailto:Ardita.Xhyheri@financa.gov.al)
39. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të drejtohen në çdo kohë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zgjidhjen e çdo problematike që shfaqet në lidhje me hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe plotësimin e Instrumentit të Planifikimit Financiar.

40. Nëpunësi i parë autorizues, nëpërmjet njësisë përgjegjëse për buxhetin vendor analizon kërkesat buxhetore të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe zhvillon takime konsultative me këto njësi sipas një kalendari të paracaktuar. Takimet me njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë në fokus kërkesat buxhetore të lidhura me financimin e buxhetit qendror për vetëqeverisjen vendore.

## VII. Të tjera

41. Pjesë integrale e këtij Udhëzimi janë shtojcat, bashkëlidhur si më poshtë:

- a) Shtojca 1 “Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2023-2025”;
- b) Shtojca 2 “Relacioni i përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”;
- c) Shtojca 3 “Treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë për periudhën 2023-2025”;
- d) Shtojca 4 “Grupi për Menaxhim Strategjik, Ekipi i Menaxhimit të Programeve- Përbërja dhe roli i tyre”;
- e) Shtojca 5 “Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore deri në nivel produkti”;
- f) Shtojca 6 “Riklasifikimi i programeve buxhetore”;

42. Instrumenti i Planifikimit Financiar, formati i përgatitjes së relacionit shoqërues së programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, mund të shkarkohen në linkun: <https://www.financa.gov.al/buxheti-i-pushtetit-vendor/>.

MINISTËR

Delina Ibrahimaj



**SHTOJCA 1****Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar e përgjithshme për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2023-2025**

Në mijë lekë

<b>Bashkia</b>	<b>2022*</b>	<b>2023 (P)</b>	<b>2024 (P)</b>	<b>2025 (P)</b>
Bashkia Belsh	124,983	133,034	141,370	150,348
Bashkia Berat	308,280	329,043	350,541	373,693
Bashkia Bulqize	273,559	291,821	310,730	331,093
Bashkia Cerrik	148,346	157,996	167,987	178,746
Bashkia Delvine	67,724	72,101	76,796	81,853
Bashkia Devoll	199,230	212,321	225,877	240,474
Bashkia Diber	425,819	453,973	483,123	514,516
Bashkia Divjake	220,870	229,753	241,086	256,562
Bashkia Dropull	83,191	88,200	94,023	100,294
Bashkia Durrës	877,905	948,138	1,016,352	1,088,029
Bashkia Elbasan	711,855	759,253	808,328	861,178
Bashkia Fier	618,189	660,291	703,884	750,829
Bashkia Finiq	125,140	133,326	141,779	150,882
Bashkia Fushe Arrez	81,069	84,881	90,351	96,241
Bashkia Gjirokaster	219,985	234,967	250,480	267,185
Bashkia Gramsh	223,688	238,400	253,632	270,037
Bashkia Has	148,628	158,605	168,935	180,059
Bashkia Himare	124,998	134,827	143,436	152,708
Bashkia Kamez	526,497	561,516	596,862	634,927
Bashkia Kavaje	226,373	244,483	262,501	279,598
Bashkia Kelcyre	62,850	66,990	71,277	75,893
Bashkia Klos	144,730	154,230	164,066	174,659
Bashkia Kolonje	124,983	132,024	140,520	149,670
Bashkia Konispol	62,899	67,819	72,068	76,644
Bashkia Korce	462,077	493,269	525,564	560,344
Bashkia Kruje	295,925	315,586	335,943	357,866
Bashkia Kucove	168,659	179,657	191,044	203,306
Bashkia Kukes	329,778	351,125	374,097	398,837
Bashkia Kurbin	234,268	250,118	266,631	284,414
Bashkia Lezhe	340,463	363,651	387,659	413,514
Bashkia Libohovë	42,729	45,615	48,603	51,821
Bashkia Librazhd	287,603	306,657	326,385	347,631
Bashkia Lushnje	417,311	450,696	480,629	511,941
Bashkia Malesi e Madhe	304,520	324,932	346,067	368,827
Bashkia Maliq	309,640	330,652	351,596	374,152
Bashkia Mallakaster	164,087	170,672	180,219	191,934
Bashkia Mat	195,016	207,856	221,193	235,556
Bashkia Memaliaj	107,766	113,085	120,388	128,252
Bashkia Mirdite	207,162	221,062	235,454	250,954
Bashkia Patos	134,575	140,130	146,041	153,481
Bashkia Peqin	134,477	143,171	152,173	161,867

Bashkia Permet	122,060	129,900	138,347	147,444
Bashkia Pogradec	371,147	395,342	420,394	447,372
Bashkia Polican	102,099	108,147	115,099	122,586
Bashkia Prrenjas	179,902	191,656	203,825	216,931
Bashkia Puke	115,050	121,738	129,625	138,119
Bashkia Pustec	36,255	38,610	41,048	43,675
Bashkia Roskovec	115,119	119,756	125,195	133,248
Bashkia Rrogozhine	148,325	158,879	168,790	179,462
Bashkia Sarande	134,873	145,663	156,361	167,120
Bashkia Selenice	176,714	190,376	202,351	215,246
Bashkia Shijak	141,939	153,295	166,903	177,676
Bashkia Shkoder	665,861	708,148	754,900	805,248
Bashkia Skrapar	127,428	135,933	144,740	154,223
Bashkia Tepelene	86,777	93,545	99,609	106,140
Bashkia Tirane	2,523,451	2,713,875	2,908,696	3,118,503
Bashkia Tropoje	212,844	227,173	242,009	257,987
Bashkia Dimal	142,830	148,619	154,985	163,368
Bashkia Vau i Dejes	230,732	246,142	262,097	279,280
Bashkia Vlore	565,117	603,604	643,454	686,369
Bashkia Vore	125,574	135,620	147,826	161,130
<b>Total</b>	<b>16,591,944</b>	<b>17,721,943</b>	<b>18,891,943</b>	<b>20,151,943</b>

*Në mijë lekë*

Qarqet	2022	2023	2024	2025
Qarku Berat	34,159	36,599	38,429	39,649
Qarku Dibër	37,453	40,128	42,134	43,472
Qarku Durrës	36,568	39,180	41,139	42,445
Qarku Elbasan	59,847	64,122	67,328	69,465
Qarku Fier	40,468	43,359	45,527	46,972
Qarku Gjirokastër	37,366	40,035	42,037	43,371
Qarku Korçë	58,619	62,807	65,947	68,040
Qarku Kukës	36,837	39,468	41,442	42,757
Qarku Lezhë	33,200	35,571	37,350	38,536
Qarku Shkodër	57,734	61,858	64,951	67,013
Qarku Tiranë	83,010	88,939	93,386	96,351
Qarku Vlorë	44,738	47,934	50,330	51,928
<b>Total</b>	<b>560,000</b>	<b>600,000</b>	<b>630,000</b>	<b>650,000</b>

\* Nuk përfshihen shtesat nga Transferta e Pakushtëzuar nga Kuvendi  
(P) parashikim

## **SHTOJCA 2**

**Relacioni i përgatitjes së programit buxhetorafatmesëm vendor, 2023-2025**

**Bashkia/Këshilli i Qarkut \_\_\_\_\_**

### **1. Vështrim i përgjithshëm (2-3 faqe)**

#### **1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore**

*Burimi i informacionit: Plani i Përgjithshëm Vendor / Plani Zhvillimit Strategjik (PPV/PZhS)*

#### **1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e Bashkisë/Këshillit të Qarkut**

*Burimi i informacionit: PPV/PZHS*

#### **1.3 Informacion financiar kryesor**

*Burimi i informacionit: Nxjerrë nga Instrumenti i i Planifikimit Financiar*

### **2. Orientimi afatgjatë i Bashkisë/Këshillit të Qarkut (2-3 faqe)**

#### **2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë**

*Burimi i informacionit: PPV/PZHS*

#### **2.1 Sfidat kryesore të zhvillimit/ Paraqitja e projekteve kryesore – arsytet dhe përfituesit**

*Burimi i informacionit: PPV/PZHS; Fishat e projekteve, të tjera*

#### **2.2 Plani i shpenzimeve kapitale 2023-2025**

*Paraqitja e projekteve kryesore të investimeve për periudhën afatmesme*

### **3. Informacion financiar**

#### **3.1 Burimi i të ardhurave**

*Analizë për parashikimin e të ardhurave për periudhën 2023-2025 (Faktorët e rritjes ose uljes së niveli të mbledhjes së taksave/tarifave). Metoda e përlllogratijes/Ndryshimet në paketën fiskale për periudhën afatmesme.*

#### **3.2 Shpenzimet**

*Analizë për parashikimin e shpenzimeve për periudhën 2023-2025 (Faktorët e rritjes ose uljes së shpenzimeve të personeli/operative/investime);*

### 3.3 Informacion financiar suplementar

#### 4.4.1 Huamarrje

*Informacion për stokun e borxhit*

#### 4.4.2 Detyrime të prapambetura

*Analizë e detyrimeve të prapambetura (arsyet pse janë krijuar, analizë sipas llojit të detyrimit). Të përcaktohet plani i shlyerjes së detyrimeve. Vlera e detyrimeve në përputhje me Sistemin e Thesarit.*

#### 4.4.3 Treguesit financiarë

*Treguesit financiarë me koment*

#### 4.4.4 Rreziqet financiare dhe fiskale

*Vlerësimi i rreziqeve financiare e fiskale dhe masat për zvogëlimin e rrezikut.*

## 4. Monitorimi i zbatimit të strategjisë së Zhvillimit të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

### 4.1 Lista e masave strategjike për çdo fushë prioritare – statusi i zbatimit

Tabela mbi zbatimin e strategjisë

Fusha prioritare	Masa strategjike	Statusi i ecurisë

### SHTOJCA 3

#### TREGUESIT KRYESOR TË KUADRIT MAKROEKONOMIK E FISKAL 2023-2025

1. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën 2023-2025, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

*në milionë lekë*

Vitet	2023	2024	2025
Transferta e Pakushtëzuar	19,870	21,070	22,350

2. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për periudhën 2023-2025, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

*në milionë lekë*

Vitet	2023	2024	2025
Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	8,800	8,800	8,850

3. Kurset e këmbimit për vitet 2018-2022, dhe parashikimi për vitet 2023-2025, bazuar në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, jepen si më poshtë:

Nr	Monedhat	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
1	Kurs i këmbimit mesatar Lek/USD	108	109.9	108.6	103.5	103.5	103.5	103.5	103.5
2	Kurs i këmbimit mesatar Lek/EURO	127.6	123	123.8	122.5	122.5	122.5	122.5	122.5

## **SHTOJCA 4**

### **Grupi për Menaxhim Strategjik, Ekipi i Menaxhimit të Programeve- Përbërja dhe Roli i tyre**

Faktor shumë i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të procesit të përgatitjes së PBA-së është prania e një strukture të përbashkët menaxhimi në secilën NJQV për të adresuar hapat e planifikimit dhe buxhetimit. Akoma më i rëndësishëm është operimi efektiv i kësaj strukture manaxhimi gjatë të gjithë procesit.

Ligji Nr. 10296/2010, datë 8/7/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, dhe Udhëzimin Nr. 23, datë 30/07/2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së PBA në NJVQV”, kërkojnë ngritjen e **Grupit për Menaxhim Strategjik** në çdo NJVQV. Përveç të tjerave, ky grup është përgjegjës për menaxhimin, sigurimin e cilësisë dhe monitorimin e procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm brenda këtyre njësive.

#### **1. Përbërja e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS).**

Grupi për Menaxhimin Strategjik i NJVQV-së krijohet me urdhër të Kryetarit të NJVQV-së dhe përbëhet nga:

- Kryetar i GMS është Kryetari i NJVQV.
- Koordinator i GMS të Bashkisë është Sekretari i Përgjithshëm ose një nga Zëvendëskryetarët e Bashkisë, sipas përcaktimit të bërë nga Kryetari i NJVQV. Në Këshillat e Qarqeve, Koordinator i GMS është Zëvendëskryetari i Këshillit të Qarkut.
- Sekretar i GMS është nëpunësi zbatues i NJVQV.
- Anëtarë të GMS janë:
  - Zëvendëskryetarët e NJVQV-së;
  - Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve buxhetore të NJVQV-së. Këta DEMP mund të jenë njëkohësisht edhe drejtues të njësive shpenzuese të varësisë apo drejtues të lartë të strukturave menaxheriale të bashkisë.
- Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimarrjeje.

#### **2. Përbërja e Ekipit të Menaxhimit të Programit (EMP)**

Drejtues i Ekipit të Menaxhimit të Programit është një drejtues i nivelit të lartë në NJVQV me ndikim të drejtpërdrejtë në politikën e programit buxhetor.

Kur një program buxhetor ka lidhje të drejtpërdrejtë me vetëm një drejtori shërbimi, përgjithësisht DEMP caktohet drejtuesi i kësaj drejtorie. Kur produktet/aktivitetet e programit realizohen në kuadrin e dy apo më shumë drejtorive, përgjithësisht DEMP caktohet drejtuesi i drejtorisë me ndikimin më të madh në politikën e programit.

Anëtarë të ekipit të menaxhimit të programit janë ekspertë të fushës së programit përkatës buxhetor, përgjegjës për menaxhimin e projekteve/produkteve/aktiviteteve që ata drejtojnë dhe japin llogari nga pikëpamja funksionale tek drejtuesi i programit.

Anëtarë të ekipit të menaxhimit të programit janë përgjegjës për realizimin e detyrave teknike për zbatimin e procedurave të përgatitjes së kërkesave buxhetore që prezantohen në këtë udhëzim dhe udhëzimeve standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, të cilat lidhen me programin e tyre.

#### **3. Vendimarrjet e GMS dhe EMP**

Menaxhimi i brendshëm i procesit të Përgatitjes së PBA-së brenda NJVQV bazohet në Vendimmarrje të Grupit për Menaxhimin Strategjik dhe Vendimmarrje të Ekipit të Menaxhimit të Programit.

Secili prej vendimmarrjeve të GMS dhe EMP që përshkruhen në këto procedura do të kërkojnë punë përgatitore, analiza dhe vendime. Secila prej këtyre vendimmarrjeve do të shoqërohet me një ose më shumë takime të grupeve përkatëse.

Figura e mëposhtme përmbledh pikat vendimmarrëse të Grupit për Menaxhimin Strategjik dhe pikat vendimmarrëse të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe rrjedhën e informacionit ndërmjet Grupit të Planifikimit Strategjik dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programit.

#### VENDIMMARRJE TË GMS NË PROCESIN E PËRGATITJES SË PBA-SË

Vendimmarrje 1 e GMS: Misioni & Organizimi	Vendimmarrje 2 e GMS: Deklarata e Politikës së Programit	Vendimmarrje 3 e GMS: Pema e Programit	Vendimmarrje 4 e GMS: Shqyrtimi i Planeve të Shpenzimeve	Vendimmarrje 5 e GMS: Shqyrtimi i Projekt Dokumentit të PBA	Vendimmarrje 6 e GMS: Përgatit Kërkesat Buxhetore të PBA
<ul style="list-style-type: none"> <li>Miraton Misionin e NJVQV;</li> <li>Miraton DEMP dhe EMP;</li> <li>Siguron të gjithë dokumentat e nevojshme të procesit;</li> <li>Detajon kalendarin për përgatitjen e PBA-së;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Miraton deklaratat e politikës së programit për çdo program buxhetor (Qëllimet e Politikës së Programit, Objektivat e Politikës së Programit, dhe Informacionin e lidhur me performancën)</li> <li>Shpërndan dhe shpjegon tavanet e përgatitjes së PBA-së.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shqyrton dhe miraton llogjikën e pemës së programit për çdo program buxhetor.</li> <li>Udhëzon DEMP për fillimin e planifikimit të shpenzimeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shqyrton informacionin mbi sasinë e produkteve dhe kostot e aktiviteteve dhe performancën e tyre..</li> <li>Propozon rishpërndarjen e tavanëve (nëse duhet)</li> <li>Udhëzon DEMP të rishikojnë sasinë e produkteve, aktivitetet dhe kostot e tyre;</li> <li>Udhëzon Kordinatorin e GMS për përgatitjen e projekt-dokumentit të PBA.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Miraton sasinë e produkteve tw lidhur me performancën dhe shpenzimet;</li> <li>Shqyrton projekt-dokumentin e PBA-së;</li> <li>Udhëzon sipas rastit pwr rishikim në projekt-dokumentin e PBA (nëse nevojitet).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shqyrtimi përfundimtar i projekt-dokumentit të PBA-së.</li> <li>Miraton versionin përfundimtar të raporteve për t'u dorëzuar në MFE.</li> <li>Përgatit dokumentat për t'u nënshkruar nga Kryetari i GMS.</li> </ul>

#### VENDIMMARRJE TË EMP NË PROCESIN E PËRGATITJES SË PBA-SË

Vendimmarrje 1 e EMP: Deklarata e Politikës së Programit (DPP)	Vendimmarrje 2 e EMP: Pema e Programit	Vendimmarrje 3 e EMP: Përgatit Planin e Shpenzimeve	Vendimmarrje 4 e EMP: Rishqyrton Planin e Shpenzimeve	Vendimmarrje 5 e EMP: Finalizon kërkesat buxhetore
<ul style="list-style-type: none"> <li>Shqyrton udhëzimet dhe dokumentat për përgatitjen e PBA-së.</li> <li>Rishikon dhe miraton DPP: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Politikën e programit</li> <li>- Qëllimet e PP;</li> <li>- Objektivat e PP;</li> <li>- Informacione të lidhura me performancën.</li> </ul> </li> <li>Dorëzon DPP tek Koordinatorin i GMS.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shqyrton tavanet e miratuara në Këshill.</li> <li>Identifikon projektet;</li> <li>Identifikon produktet;</li> <li>Identifikon aktivitetet;</li> <li>Përgatit Pemën e Programit dhe e dorëzon tek Koordinatorin i GMS.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Diskuton dhe miraton: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Specifikimet e produkteve;</li> <li>- Lidhjen e produkteve me objektivat dhe projektet;</li> <li>- Specifikimet e aktiviteteve;</li> <li>- Përcakton sasinë e produkteve dhe informacionin e lidhur me performancën;</li> <li>- Planifikon shpenzimet për aktivitetet;</li> <li>- Mbyll mangësitë në financim;</li> <li>- Dorëzon planin e shpenzimeve tek Koordinatorin i GMS;</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishqyrton dhe miraton planin e shpenzimeve;</li> <li>Rishqyrton dhe miraton DPP nëse nevojitet;</li> <li>Dorëzon dokumentet e mësipërme tek Koordinatorin i GMS.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përgatit versionin përfundimtar të DPP dhe raporteve të planeve të shpenzimeve.</li> <li>Dorëzon versionin përfundimtar të raporteve tek Koordinatorin i GMS</li> </ul>

**SHTOJCA 5**

**Formati standard i përgatijes së kërkesave buxhetore deri në nivel produkti**

**FORMATI STANDARD I PËRGATITJES SË KËRKESAVE BUXHETORE PBA –2023-2025\***

Programi Buxhetor Afatmesëm 2023 - 2025				
<b>Emërtimi i Programit Buxhetor</b>	Menaxhimi i Mbetjeve			
<b>Kodi i Programit</b>	05100			
<b>Programi Buxhetor Afatmesëm</b>	2023 - 2025			
<b>Përshkrimi i Programit</b>				
Mbledhjen, depozitimin e mbeturinave, trajtimin, pastrimin e rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtjen e ajrit dhe e klimës, mbrojtjen e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimin e zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtjen ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore				
<b>Qëllimet e Politikës së Programit</b>	Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve iu ofrohen familjeve dhe bizneseve në të gjithë bashkinë sipas standarteve të përcaktuara në marrëveshjen e shërbimit të vitit 20xx të bashkisë (referenca ... ) deri në 2025			
Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2022 Buxheti	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	2025 Parashikimi
Emërtimi i Treguesit x (shto tregues sipas rastit)	Vlera Bazë	Vlera e Synuar	Vlera e Synuar	Vlera e Synuar
<b>Objektivi 1 i Politikës së Programit</b>	Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve iu ofrohen 80% të familjeve dhe 60% të bizneseve në bashki sipas standarteve të përcaktuara në marrëveshjen e shërbimit të vitit 20xx të bashkisë (referenca ... ) deri në 2022			
Treguesit e Performancës për Objektivin 1				
Mbulimi i familjeve me shërbimin e mbledhjes së mbetjeve	70%	80%	85%	90%
Mbulimi i bizneseve me shërbimin e mbledhjes së mbetjeve	45%	60%	65%	70%
<b>Produktet për Objektivin 1</b>				
<b>Shpenzimet Korrente</b>				
<b>Produkti 1</b>	Mbetje të mbledhura nga familjaret			
Përshkrimi i Produktit:	Mbetje të mbledhura nga familjaret në bashki brenda 2023, me shërbimet e mbledhjes së mbeturinave një herë në javë			
Njësia Matëse	tonë mbetje			
	2022 Buxheti	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	2025 Parashikimi
Sasia	2800	3000	3188	3375
Kosto totale (në mijë lekë)	11,858,000	13,935,000	13,867,800	14,920,875
Kosto për njësi (në mijë lekë)	4,235	4,645	4,350	4,421
Ndryshimi në % i Sasisë		7.14%	6.27%	5.87%
Ndryshimi në % i kostos totale		17.52%	-0.48%	7.59%
Ndryshimi në % i kostos për njësi		9.68%	-6.35%	1.63%
<b>Shpenzimet Kapitale</b>				
<b>Kategoria 1: Shpenzimet Administrative Kapitale</b>				
<b>Kodi i Projektit të Investimeve</b>				

Produkti 1 :		Kodi i Projektit sipas listes se investimeve	
Përshkrimi i Produktit:			
Njësia Matëse			
	2022 Buxheti	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi
Sasia			
Kosto totale (në mijë lekë)			
Kosto për njësi (në mijë lekë)			
Ndryshimi në % i Sasisë			
Ndryshimi në % i koston totale			
Ndryshimi në % i koston për njësi			
Kodi i Projektit të Investimeve****			
Produkti 2 :	Makineri për mbledhjen e mbetjeve	Kodi i Projektit sipas listes se investimeve	
Përshkrimi i Produktit:	Blerje e një makinerie me karakteristikat XXX për mbledhjen e mbetjeve në qytet.		
Njësia Matëse	Numër Makinerish		
	2022 Buxheti	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi
Sasia	0	0	1
Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	6,100,000
Kosto për njësi (në mijë lekë)	N/A	N/A	N/A
Ndryshimi në % i Sasisë	N/A	N/A	N/A
Ndryshimi në % i koston totale	N/A	N/A	N/A
Ndryshimi në % i koston për njësi	N/A	N/A	N/A
<b>Kategoria 2: Projekte investimi dhe kosto lokale</b>			
Kodi i Projektit të Investimeve			
Produkti 1		Kodi i Projektit sipas listes se investimeve	
Përshkrimi i Produktit:			
Njësia Matëse			
	2022 Buxheti	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi
Sasia			
Kosto totale (në mijë lekë)			
Kosto për njësi (në mijë lekë)			
Ndryshimi në % i Sasisë	...		
Ndryshimi në % i koston totale	...		
Ndryshimi në % i koston për njësi	...		

Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	
	Nenshkrimi	
	Data	

\*Ky format plotësohet në përputhje me përcaktimet e pikës 4.2 të udhëzimit standard nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm në njësitë e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar.

## SHTOJCA 6

Në zbatim të *Udhëzimit nr.7, datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, Shtojca nr.1* që përban listën e programeve që përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore ka ndryshuar nëpërmjet riklasifikimit të programeve, duke ulur numrin e tyre nga 36 në 20. Ndryshimet sqarohen si më poshtë:

1. **Programi 01110** “Planifikim, menaxhim dhe administrim” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin dhe aktivitetet e programit 01120 “Çështje financiare dhe fiskale”, programit 01170 “Gjendja Civile” dhe programit 01710 “Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm”;
2. **Programi 03140** “Shërbimet e Policisë Vendore” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin e programit 03600 “Marrëdhëniet në komunitet”;
3. **Programi 03280** “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” nuk ndryshon;
4. **Programi 04130** “Mbështetja për zhvillim ekonomik” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin dhe përshkrimin e programit 04160 “Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi”, programit 04740 “Projekte zhvillimi” dhe programit 04760 “Zhvillimi i turizmit”;
5. **Programi 04220** “Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve” nuk ndryshon;
6. **Programi 04240** “Menaxhimi i infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit” nuk ndryshon;
7. **Programi 04260** “Administrimi i pyjeve dhe kullotave” nuk ndryshon;
8. **Programi 04520** “Rrjeti rrugor rural” nuk ndryshon;
9. **Programi 04570** “Transporti publik” nuk ndryshon;
10. **Programi 05100** “Menaxhimi i mbetjeve” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin dhe përshkrimin e programit 05320 “Programe për mbrojtjen e mjedisit” dhe programit 05630 “Ndërgjegjësimi mjedisor”;
11. **Programi 06140** “Planifikimi Urban Vendor” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin dhe përshkrimin e programit 06210 “Programet e zhvillimit”;
12. **Programi 06260** “Shërbimet publike vendore” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin dhe përshkrimin e programit 06440 “Ndriçim rrugësh”;
13. **Programi 06370** “Furnizimi me ujë dhe Kanalizime” është riklasifikim me kod të ri i programit 06330 “Furnizimi me ujë” si dhe përfshin edhe objektivin dhe përshkrimin e programit 05200 “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve”;
14. **Programi 07220** “Shërbimet e kujdesit parësor” nuk ndryshon;
15. **Programi 08130** “Sport dhe argëtim” nuk ndryshon;
16. **Programi 08220** “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore” nuk ndryshon;
17. **Programi 09120** “Arsimi bazë përfshirë parashkollorin” nuk ndryshon;
18. **Programi 09230** “Arsimi i mesëm i përgjithshëm” përfshin edhe përshkrimin e programit 09240 “Arsimi profesional”;
19. **Programi 10430** “Përkujdesja Sociale” riklasifikohet në emërtim dhe ndryshon duke përfshirë objektivin dhe përshkrimin e programeve 10140 “Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara”, 10220 “Sigurimi shoqëror”, 10550 “Papunësia, arsim dhe aftësim”;
20. **Programi 10661** “Strehimi social” nuk ndryshon.

Për vitet e kaluara Instrumenti i Planifikimit Financiar do të plotësohet duke rialokuar fondet e përdorura nëpër programe sipas riklasifikimit të mësipërm.